

Njësia Nr./Br./No 02(Kabinet i Kryetarit të Komunës)


Nr./Br./No 2764 Nr. ifaq/Br.str/No.pg 48

Data/Datum/Date 3/10/22

RAHOVEC / ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC

**BULETINI MUJOR KOMUNAL
SHTATOR 2022**



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE.....	3
PËRFUNDIM.....	15

HYRJE

Ky buletin është krijuar me idenë e promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2022.

Rrëndësia e botimit të buletinit mujor qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit, në mënyrë të tillë që t'i mundësojmë qytetarit të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Muaji shtator i vitit 2022, është karakterizuar me një sërë aktivitetesh të kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin shtator, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE

Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Afrim Limani, sipas afatit ligjor zyrtarisht e dorëzoi dokumentin e propozim-buxhetit për vitin 2023-2025 kryesuesit të Kuvendit Komunal të Komunës së Rahovecit, z. Defrim Kafexhiu.

Në buxhetin për vitin 2023 janë përfshirë edhe një numër i konsiderueshëm i projekteve të rëndësishme për Komunën e Rahovecit, kërkesa dhe propozime të bëra nga qytetarët gjatë dëgjimeve buxhetore që janë mbajtur në qytet dhe në të gjitha fshatrat.



Pas dy vitesh pamundësie për ta realizuar mbajtjen Festivalit të Vjeljes së Rrushit "Hardh Fest", sivjet festivali është mbajtur me organizimin më të mirë në historikun e tij.

Festivali "Hardh Fest" e ka vendosur Rahovecin në hartën e ngjarjeve kulturo-artistike më të rëndësishme të Kosovës, ndërsa Kosovën e ka vendosur në hartën e madhe të botës dhe jorastësisht, kemi vizitorë nga pjesë të ndryshme të Evropës dhe botës.

Në 24 vjetorin e betejës për Zatriqin dhe rënies në krye të detyrës të tre dëshmorëve nga ky fshat, kryetari Latifi bëri homazhe për ndër të Mazlum Kastrati, Xhafer Vehapi dhe Esat Kastrati nga Zatriqi, të cilët u pavdekësuan me pushkë në dorë në betejën e 3 shtatorit 1998.





Kryetari Smajl Latifi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, si dhe me përfaqësuesit e OVL-UÇK, në prani të familjarëve, bashkëluftëtarëve dhe miqve, në nderim të kuçimit për dëshmorët dhe maritrët, bën homazhe në Dobidol para lapidarit të dëshmorit të kombit, Mark Sopjani, i rënë me 4 shtator 1998, si dhe në Dejnë, për dëshmorin Arben Bytyçi, i rënë me 4 shtator 1998.

Për tri ditë rresht, me 2, 3 dhe 4 shtator, në Rahovec, u mbajt Festivali i Vjelses së Rrushit "Hardh Fest", ku qytetarë nga mbarë Kosova dhe jashtë saj, u kënaqën me aktivitetet e shumta ditore dhe koncertet e tri netëve që kishin përgatitur për sivjet organizuesit e festivalit "Hardh Fest". Festa e rrushit që dikur shënohej në mënyrë simbolike nga vreshtarët lokalë të Rahovcit, tanë është shndërruar në një festival madhështor, shumëngjyrëshe e rekreative.

"Hardh Fest"-i tashmë është shndërruar në një ngjarje të madhe kulturore që i sjell krenari të madhe komunës sonë të vogël, por të pasur me njerëz të mirë, punëtorë e mikpritës si askund tjeter.



Kryetari Smajl Latifi, së bashku me stafin e tij, në 24 - vjetorin e rënies, në prani të bashkëluftëtarëve, qytetarëve dhe familjarëve të dëshmorëve, bëri homazhe për jetën dhe veprën e pavdekshme të dëshmorëve të atdheut Shani Hoti dhe Afrim Bajraktari, si dhe të martirëve nga fshati Polluzhë.

Kryetari Latifi priti në vizitë një grup studentësh të shoqëruar nga profesorët e Fakultetit të Bujqësisë në Universitetin e Giessen nga Gjermania, Rainer dhe Till, si dhe profesorin z. Arben Mehmeti nga Fakulteti i Bujqësisë i Universitetit të Prishtinës.

Studentët të cilët qëndruan në Kosovë, patën mundësinë të vizitojnë edhe Qendrën Grumbulluese të Pemëve dhe Perimeve "Agro Celina", kompaninë "Stone Castle" dhe disa kompani të tjera në komunën tonë.



Kryetari Latifi, së bashku me Drejtorin e Shërbimeve Publike, Përparim Krasniqi, priti në një takim të veçantë delegacionin nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, z. Shpend Terdeva, Drejtor i DSSH-së, z. Kastriot Lajçi, Kryeinspektor në MPB-AME, z. Valon Krasniqi, Drejtor i DZSH-së dhe z. Dardan Lushtaku, Zyrtar i Financave në AME, ku diskutuan për projekt-planin komunal për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësítë elementare natyrore dhe të tjera, planet operative të zjarrfikësve, nevojën për shtimin e personelit të zjarrfikësve, projektligjin e ri të AME, angazhimin e inspektoratit për parandalimin e ndërtimeve pa leje.

Në një takim përshëndetës, kryetari Smaji Latifi priti komandantin e deritanishëm të LMT -së, z. Gerhard Kopf dhe komandantin e ardhshëm të LMT -së në Rahovec, z. Manfred Bernhard.

Komandantin Kopf, e falënderoi për bashkëpunimin dhe angazhimin e tyre në mbikëqyrjen e sigurisë, ndërsa komandantit të ri të LMT-së, z. Manfred Bernhard, i uroi mirëseardhje dhe bashkëpunim të mëtutjeshëm!



Në Palestrën Sportive "MIZAHIR ISMA" në Rahovec, ka filluar Kampionati i Basketbollit në Superligën e Kosovës. Atmosferë e bukur dhe e zjarrtë prej simpatizuesve të shumtë të klubit të tyre të dashur, KB "Rahoveci", i cili ka luajtur kundër KB "Golden Eagle Ylli" në ndeshjen e parë në shtëpi.



Kryetari Smajl Latifi, së bashku me bashkëluftëtarë, ishin në vendin e quajtur Bogiqe, te trekëndëshi kufitar: Kosovë - Shqipëri - Mal i Zi, i përshkuar nga shumë luftëtarë të shquar të lirisë që për mision kishin, të bartnin mbi supet e tyre të njoma barrën e madhe të hapjes së shtigjeve të vështira për luftën çlirimtare. Së bashku me ta ishin edhe familjarë të dëshmorëve në përvjetorin e rënies së dëshmorëve Shpëtim Bobi, Sadri Vishaj dhe Xhevrat Sejfijaj, e për t'i kujtuar të gjithë ata që ranë në këtë pjesë të atdheut tonë të ndarë dhunshëm, poashtu ishin edhe afër vendit ku ra njëri prej bijve më të shquar në historinë më të re të luftës për çlirimin e atdheut, bashkëveprimtari, heroï i kombit, Bahri Fazliu.

Bashkë me nënkyetarin, z. Fatmir Iska, drejtoreshën për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, znj. Saranda Sallteku dhe drejtorin e QKMF "Dr. Fahredin Hoti", dr. Elbunit Kryeziu, kryetari Smajl Latifi ka mbajtur takim me punonjësit shëndetësor, me të cilët diskutuan për situatën pandemike, kapacitetet shëndetësore, shërbimet e ofruara dhe kushtet e punës në këtë institucion, investimet që po bëhen në objektin e vjetër të QKMF - së dhe planet për të ardhmen.





Kryetari Latifi, së bashku me drejtorin e DKRS-së, z. Afrim Dina, kryetarin e fshatit, z. Mirsad Qehaja, me bashkëpunëtorë e qytetarë të Retisë së Ulët, në një entuziazëm dhe gjëzim, përuroi mjediset e reja sportive për futboll, basketboll dhe volejboll, që do t'u shërbejnë të rinjve dhe të gjithë qytetarëve të fshatit për sport e rekreacion.

Së bashku me drejtorin e BPZHR në Rahovec, z. Berat Duraku, kryetari Smajl Latifi priti në zyrën e tij, Kryetarin e Mamushës, z. Abdylhadi Krasniqi dhe drejtorin e bujqësisë të kësaj komune, z. Ruzhdi Mazreku. Takimi u karakterizua nga bashkëbisedimi për gjendjen aktuale, ecurinë e punëve dhe vështirësitet me të cilat po ballafaqohemi, për arritjet që po i bëjmë për komunat tona si dhe u pajtuan të thellojmë bashkëpunimin për projekte me interes për të dy komunat dhe për çështje të tjera të interesit të përbashkët.



Është kompletuar shpërndarja e pajisjeve për bujqit përfitues, ku edhe 40 bujq kanë pranuar pajisje bujqësore:

- 30 frezë 1.8 m - për 30 bujq
- 2 frezë 1.6 m - për 2 bujq dhe
- 8 mulqere për hardhi - për 8 bujq.

Ndërkohë, pajisjet e tjera të mbeturë për t'u shpërndarë, pritet të arrijnë gjatë muajit tetor.

Dëme të mëdha nga vërshimet dhe përmbytjet në Rahovec, ku që nga orët e hershme të mëngjesit jemi ballafaquar me gjendje të rënduar, pas reshjeve të shumta të shiut, e për këtë qëllim kemi formuar edhe Shtabin Emergjent të komunës së Rahovcit. Përmbytjet nga ujërat dhe pasojat që kemi pasur në në shtëpi banimi, ekonomi familjare, biznese, hapësira dhe objekte publike, bujqësi etj. i kemi parë nga afër në shumë zona të komunës sonë, posaçërisht, në: Fortesë, Sapniq, Ratkoc, Malësi e Vogël, Gexhë, Celinë, Xërxi, Dejnë, Krushë e Madhe, Nagac, Çifllak, Hoçë e Vogël, Dobidol, etj. Drejtoria e Shërbimeve Publike me Njësinë e Zjarrfikësve, Drejtoria e Bujqësisë, Stacionin Policor Rahovec, kompanitë e kontraktuara nga komuna jonë dhe ekipet e shumta vullnetare, kanë punuar pandërprerë, në mbrojtje të qytetarëve dhe pronave të tyre si dhe përvitimin e rezikut nga vërshimet, si dhe sanimin e pasojave.




Kryetari Latifi, priti në takim ministrin e MPB, z. Xhelal Sveçla, ministrin e MAPL, z. Elbert Krasniqi, zëvendësministrin e bujqësisë, z. Imri Demelezi, drejtorin e AME, z. Shefki Abdullahi, me të cilët vizituan nga afër zonat e goditura nga vërshimet dhe përmbytjet. Kryetari Latifi ka kërkuar përkrahje konkrete nga ministrat, masa dhe veprime për t'u dalë në ndihmë qytetarëve të komunës së Rahovcit.



Drejtori i BPZHR-së, Berat Duraku, nga orët e hershme të mëngjesit, bashkë me anëtarë të Shtabit Emergjent të kryesuar nga Kryetari Smajl Latifi, kanë qenë në terren duke u dalur në ndihmë banorëve të rezikuar nga vërshimet e krijuara nga shirat e rrëmbyeshëm. Nga e hëna komisionet do të janë në terren dhe do të evidentohen të gjitha humbjet që iu janë krijuar banorëve të komunës sonë, kurse pas raportit përfundimtar, ne do të kërkojmë mbështetje financiare nga Qeveria e Kosovës, ngase ne si komunë nuk kemi fond përkompensim nga fatkeqësitet natyrore.

Në varrezat e dëshmorëve në Landovicë, kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorë, në prani të familjarëve, miqve dhe bashkëluftëtarëve, bëri homazhe për njeriun dhe shokun më të mirë e të dashur, bashkëluftëtarin e dëshmuar për sakrificën dhe përkushtimin atdhetar, komandantin dhe dëshmorin e lirisë Skender Gashin, në 22 vjetorin e ndarjes së padrejtë ngajeta dhe detyrat e tij në shërbim të lirisë e të forcimit të paqes që shqiptarët e këtij nënqelli janë fluar ndër breza.



Kryetari Latifi së bashku me bashkëpunëtorë, priti për vizitë ministrin e Ministrisë së Mbrojtjes, z. Armend Mehaj, me rastin e vërvshimeve që kanë ndodhur nga reshjet e fundit në komunën e Rahovecit me datë 17.09.2022. Pas vlerësimit të gjendjes faktike, ekipe e FSK-së, kanë ndërhyrë me makineri për hapjen e disa kanaleve dhe vijave për të pasur shkarkime më të papenguara të ujërave në Drinin e Bardhë.


Me vendimin e tij si Kryetar komune, pas situatës së krijuar nga reshjet e dendura dhe të rrëmbyeshme atmosferike, janë formuar shtatë komisione për vlerësimin e dëmeve, në: amvisëri, ekonomi të shumta familjare e biznese, bujqësi dhe infrastrukturë publike. Komisionet kanë marrë detyrën menjëherë për të filluar punën në terren, për të bërë regjistrimin dhe më pas vlerësimin e dëmeve nga reshjet e shiut, të cilat i kanë përmbytur dhe vërvshuar disa zona të komunës sonë.





Së bashku me shokë, familjarë e bashkëluftëtarë, kryetari Latifi, bëri homazhe në varrezat e dëshmorëve në Landovicë, për ndër të 22 vjetorit e në nderim të tre dëshmorëve të UÇPMB-së: Shkelzen Krasniqi, Betim Berisha dhe Eqrem Hoxha, të rënë heroikisht 22 vjet më parë në fshatin Dobrosin të Kosovës Lindore.

Është shënuar Dita e Pastrimit të Botës, ku ne si komunë jemi të përkushtuar dhe punojmë vazhdimisht për një mijedis të pastër e kushte të mira jetese, kemi investuar në pastrim të deponive ilegale që kanë qenë një barrë e madhe për qytetarët, kemi investuar në gjelbërim, kemi ndërtuar parqe si dhe kemi mbjellur drunj dekorues në qytet por edhe në zona rurale.



Kryetari Smajl Latifi ka mirëpritur në takim komandantin e KFOR-it italian për Rajonin Perëndimor, z. Ivano Marotta.

Në këtë takim, u diskutua për projektet që janë duke u zhvilluar në Komunën e Rahovecit, me theks të veçantë u diskutua për situatën e sigurisë. Kryetari e informoi komandantin Marotta për aktivitetet komunale, investimet dhe punët që po vazhdojnë të bëhen, si dhe e falënderoi për përkrahjen dhe mundësinë e bashkëpunimit në fusha të ndryshme.

Kryetari Latifi ka mirëpritur në takim Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, me bashkëpunëtorët e tij. Në takim është diskutuar për ç'bllokimin e projekteve të cilat ka kohë që i presim, ndër to janë edhe memorandumet e bashkëpunimit të nënshkruara me MKRS, që nga prilli 2019, si dhe për projektet e reja për Komunën e Rahovecit. Bashkëbiseduam po ashtu edhe për përkrahjen nga MKRS që i nevojitet Komunës sonë për projekte konkrete, në fushën e trashëgimisë kulturore e historike, për rininë si dhe në investime kapitale në kulturë dhe sport.




Kryetari Latifi ka pritur në takim pune znj. Jenifer Ober, drejtoreshë e aktivitetit të USAID-it dhe z. Ramadan Klisurica, përfaqësues i projektit "Qeverisja e Pronës", i cili do të realizohet nga USAID. Bashkë diskutuam për jetësimin e projektit të ri "Qeverisja e Pronës", ku komuna e Rahovecit është njëra ndër pesë komunat përfituese të këtij projekti.

Fokus i këtij projekti do të jetë:

1. Ofrimi i shërbimeve më të mira pronësore nga ana e komunës së Rahovecit,
2. Pjesëmarrja e grave dhe avansimi i rolit të gruas në prona,
3. Roli i bizneseve në çështjet pronësore.

Në përvjetorin e rënies së tyre, kujtojmë betejat, luftën dhe sakrificën e Heroit dhe Heroinës së Kombit, Fehmi e Xhevë Lladrovci, si një edukim dhe mësim për brezat dhe frymëzim i pashtershëm për tërë kombin tonë!

Fehmi e Xhevë Lladrovci, së bashku me luftëtarin Fatime Hetemi e luftëtarin Shefqet Zeka, ranë në një ditë e në të njëjtën betejë, për të njëjtin qëllim e për të lartin ideal, e si një dëshmi e përkushtimit, angazhimit të pakompromis për çlirimin e truallit tonë nga zgjedha e robërisë sllave.





Në mbledhjen e nëntë të rregullt të Kuvendit Komunal të Rahovecit, është miratuar buxheti për vitin fiskal 2023.

Ky buxhet vjen pas konsultimeve të mbajtura me qytetarë, biznese, shoqërinë civile, fermerë, gjithashtu, pas dëgjimeve publike buxhetore e vlerësimeve nga profesionistë të të gjitha fushave, në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal të Rahovecit, u miratua buxheti për vitin 2023, i cili në total (për të gjitha kategoritë buxhetore) kap vlerën prej 17,548,240.00 €.

Komuna e Rahovecit, gjegjësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ka filluar punimet për rregullimin e parkut në fshatin Nagavc. Ky projekt parashev një hapësirë të re gjelbëruese dhe relaksuese për të gjitha grupmoshat.



Kanë vazhduar punimet në projektin për ndërtimin dhe rregullimin e kanaleve për trajtimin e ujërave atmosferik.

Punimet po vazhdojnë me intensitet të lartë në kanalin në fshatin Celinë.

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Berat Duraku, ka mirëpritur ekipet e FSK-së, të cilat kanë zbarkuar me makineritë e tyre për të mundësuar kështu pastrimin dhe hapjen e disa përrënjeve problematikë.

Pas vlerësimit të gjendjes faktike nga reshjet e fundit në komunën tonë, ekipet e FSK-së, do të ndërhyjnë me makineri për hapjen e disa kanaleve dhe vijave për të pasur shkarkime më të papenguara të ujërave në Drinin e Bardhë.



Kryetari Latifi ka mbajtur takim me ministren e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, znj. Rozeta Hajdari, ku bashkëbiseduan për investimet në Zonën Ekonomike - Parkun Industrial në Opterushë. Ministrja Hajdari konfirmoi, se MINT do ta përkrahë me 1,5 milionë € këtë projekt të rëndësishëm për biznese, zhvillim ekonomik dhe punësim. Sipas marrëveshjes së mirëkuptimit për bashkëfinancim, të nënshkruar me MINT, MINT do ta përkrah projektin me 1,5 milionë €, ndërsa komuna e Rahovecit me 300 mijë €, në total ky investim kap vlerën, gjithsej 1,8 milionë €.

Kryetari Smajl Latifi, ka pritur në takim zyrtarë nga USAID, në krye me drejtoreshën Jennifer Ober dhe kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit në mes të Tetra Tech ARD, Inc. - Zbatuesi i Aktivitetit të USAID Kosovë - Qeverisja e Pronës dhe Komunës së Rahovecit, në lidhje me Zbatimin e përbashkët të aktivitetit Qeverisja e Pronës. Aktiviteti Qeverisja e Pronës, është një aktivitet pesëvjeçar që synon të përmirësojë sistemin e të drejtave pronësore në Kosovë për të reduktuar korruptionin, rritur fuqizimin e grave dhe përmirësuar të drejtat formale të pronës dhe investimet në pronën e paluajtshme. Aktiviteti, në partneritet me shoqërinë civile, sektorin privat dhe akterë të tjera do të avancojnë zhvillimin ekonomik dhe demokratik në Kosovë.



Kryetari Latifi ka mirëpritur për vizitë ambasadorin e Austrisë në Republikën e Kosovës, z. Christoph Weidinger, z. Karl Wilfing, Kryetar i Kuvendit të Austrisë së Ulët, z. Karl Moser, Nënkyetar i Kuvendit të Austrisë së Ulët, me bashkëpunëtorët e tyre. Ambasadorit Weidinger dhe bashkëpunëtorëve të tij, kryetari i uroi mirëseardhje dhe i shprehu falënderim për mbështetjen që Austria i ka dhënë në vazhdimësi Kosovës. Gjithashtu, ambasadori u njoftua për aktivitetet dhe planet e komunës së Rahovecit dhe shprehëm gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë. Gjatë takimit bashkëbiseduan edhe për vlerat kulturore e turistike që ofron komuna jonë dhe për potencialet tona zhvillimore.



Në shtëpinë e Kulturës në Krushë të Madhe, në prani të familjarëve e miqve, është mbajtur orë përkujtimore në 1 - vjetorin e ndarjes nga jeta të Avdi Durakut. Avdiu do të kujtohet për veprimtarinë e gjatë në rrugën e lirisë, shpirtin e tij njerëzor, burrëri e ndershëmëri, besnikëri në bindjet e tij dhe shpirtin e madh veprues, maturinë dhe përvojën jetësore, përkrahjen e luftës çlirimtare, respektin ndaj familjeve të dëshmorëve e të martirëve dhe respektin ndaj luftëtarëve të UÇK-së. Emri i Avdi Durakut do të jetojë në kujtesën tonë dhe të atyre që vijnë pas nesh, sepse vepra jetësore e tij, ishte në shërbim të lartësimit të vlerave njerëzore, atdhetare dhe kombëtare.

Kryetari i Komunës, z. Smajl Latifi ka nderuar me mirënjoje pjesëtarët e Gardës Kombëtare me kuadrot profesionale xheniere, të cilët përditë me radhë, me përkushtim të madh, kanë bërë një punë të jashtëzakonshme me dy eskavatorë, për pastrimin e shtratit të lumit Bellaja deri te hekurudha, në të cilin derdhen tre përrenj: Duhollo, Rimniku dhe përroi që vjen nga Sapniqi. Gjithsej janë pastruar dhe rregulluar 1380 metra.



PËRFUNDIM

Ky buletin përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë muajit shtator 2022.

Fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, e një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit.

Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin, porse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij buletini muJOR ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t’iu dhënë mundësi qytetarëve që të njojin dhe vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gjelqojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, shtator 2022